

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

Të them të drejtën, unë nuk do të kisha munguar në këtë seancë për asnjë arsye, pasi më duhet të dëshmoj edhe në vetë të parë atë se çfarë ne paralajmëruam më herët në lidhje me qëllimet tuaja dhe pse-të e të ashtuquajturit revolucion. Sot është rasti për të konfirmuar përmes qëndrimeve dhe fjalëve tuaja se ka vetëm një njeri të interesuar dhe këto janë thjesht e vetëm arsyet e një njeriu të vetëm që kërkon ta degradojë jetën parlamentare, të shkaktojë tension dhe ta tërheqë vëmendjen nga problemet e vërteta që ka vendi dhe nga nevoja për të propozuar, për të gjetur dhe për të dakordësuar zgjidhje. Unë nuk e bëra atë që shumë kolegë e bënë dje, që shkruan në Facebook për vrasjen e 3 qytetareve, të 3 zonjave. Nuk e bëra, sepse mendoj se ndryshe nga ata që përdorin Facebook-un, ne kemi diçka më shumë për të bërë dhe diçka më shumë për të thënë. Ajo që duhej të bënim nga sot e në vijim, dhe duhet ta bëjmë patjetër, është t'i stresojmë organet, në kuptimin pozitiv të fjalës, që vijnë e japin llogari një herë në vit këtu, por kjo llogari është shndërruar thjesht dhe vetëm në formale, një llogari që nuk dëgjohet, që të bëjnë punën e tyre. T'i stresojmë organet që t'i ndërrojnë politikat e tyre dhe këta njerëz të mos e kenë kaq të lehtë kalimin në filtrin e drejtësisë. Unë po i kthehem edhe një herë fillimit, sepse këto fjalë doja t'i ndaja sa me ju, aq edhe me publikun. McGonigal-i nuk ka asnjë lidhje, dhe, në fakt, nuk duhej të kishte asnjë lidhje, me Shqipërinë, por opozita e gjen dhe e bën lehtësisht lidhjen kur i nevojiten rrugët e shkurtra, edhe pse këtë e ka provuar shumë herë, e ka stërrprovuar, dhe gjithmonë ka dalë e dështuar. Nuk është as e re, dhe nuk është as sajese që në vitin 2017 ju kërkua të lobonit në SHBA me rubla ruse. Ju lobuat me rubla ruse të rrjedhura përmes kompanive offshore, të cilat kontrolloheshin nga rusë. "BIRN"-i e tha i pari këtë gjë në nëntor të vitit 2017, mandej e shkroi revista e njohur amerikane "Mother Jones". E thanë hetimet e nisura në SHBA nga Departamenti i Drejtësisë ndaj lobistit amerikan Muzin; hetimet që nisën këtu (dhe dua të sillni në vëmendje reagimet që mbajti ish-kreu juaj ndaj prokurorisë së Tiranës, deklaratimet e tij kontradiktore në media), mandej faktin e dëshmoi edhe Agjencia e Inteligjencës Amerikane (CIA), duke nënvizuar në të njëjtën kohë rrezikun që u kanoset sot e gjithë ditën zgjedhjeve të lira, demokracisë në disa vende të Europës, madje në të gjithë botën, edhe në SHBA, për shkak të ndikimit rus.

Të gjithë bashkë, kokë e këmbë, ishit në këtë aferë, pavarësisht se sot një shumicë këtu i lan duart si pa të keq, njësoj si Ponc Pilati. Kur ishte koha, as nuk e denoncuat, as nuk u distancuat, bëtë sikur dhe, sapo u shfaq në skenë një i dyshuar për favorizim të një oligarku rus, vrapuat kush e kush i pari për ta deformuar këtë të vërtetë. Lulzim Basha lloboi për vete, por lloboi edhe për të gjithë ju, për secilin nga ju, me para ruse, sipas parimit "qëllimi justifikon mjetin". Nuk ia gjetëm ne miqtë e tij rusë, as agjentët e huaj "Muzin dhe kompani", as kongresmenët amerikanë që takonte zoti Basha, të njohur si miqtë e Putinit, dhe as ata që ai takoi përgjatë gjithë pranverë-verës të vitit 2017. Sigurisht, nuk ia bëmë ne lidhjet me turkun Alptekin. Nuk e yshtëm ne në këto gjëra. Këta ishin miqtë tuaj, të cilët më shumë se për mënyrën se si i zgjidhni ju miqtë, flasin për qasjen skandaloze, krejtësisht të paprincipitë që keni për mënyrën e ardhjes në pushtet: përmes lobimeve, pagesave, kanaleve thelbësisht antishqiptare, antieuropiane, antiamerikane. Këto janë ato që u duhen thënë me zë të lartë qytetarëve, në mënyrë që ata t'ju identifikojnë siç duhet dhe t'ju japin atë që meritoni. Po, këtë do të duhej ta kishte bërë më herët sistemi i drejtësisë, ai për të cilin ne ende nuk mund të krenohemi edhe pas reformës në drejtësi, me gjasë, sepse na duhet ende kjo përballja që të ndajë "thikë" grurin nga egjra dhe të mund ta detyrojë politikën që të formësojë një tjetër vullnet politik edhe më të fortë për mostolerimin e askujt dhe të asgjëje që bie ndesh me interesat e Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Në verën e vitit 2021, fill pas

zgjedhjeve të fundit të përgjithshme, Sali Berisha u shpall non grata nga Departamenti i Shtetit. U shpall non grata për korrupsion masiv, dhe i njëjti veprim pak kohë më pas u pasua edhe nga Britania e Madhe. Sali Berisha ka dy vjet që e mban peng Partinë Demokratike për interesat e tij personalë. Ka dy vjet që gënjen edhe të gjithë pasuesit e tij, pasi premtoi për një gjyq ndërkombëtar, premtoi për një gjykatë në Francë, që do ta zhbënte vendimin e aleatit tonë të madh strategjik, që e shpalli Berishën dhe familjen e tij si të papëlqyeshëm dhe të papranueshëm.

Sot, dy vjet më pas, asgjë nuk ka ndryshuar në vendimmarrjen e këtyre vendeve, përkundrazi, veprimet që ndërmori Berisha duke sulmuar bashkëpunëtorin e tij më të afërt, mëkëmbësin e tij në Partinë Demokratike, anëtarët dhe selinë e Partisë Demokratike, i bëri këto vende që përmes diplomatëve të tyre të bënin të qartë se është vijë e kuqe mes vendit tonë dhe vendit të tyre njësimi me Sali Berishën dhe veprimet e tij. Dalja në skenë e një personazhi të lartë të kundërzbulimit amerikan dhe dyshimit se ai ka favorizuar dikë në kundërshtim me ligjet e vendit të tij, u pa si gjetja e re e Sali Berishës, se me demok gjithçka ishte kurdisur prej këtu nga mazhoranca. Fatmirësisht, non grata e Sali Berishës e ka një emër, e ka emrin "korrupsion", sepse për korrupsionin e tij dhe të familjes së tij, për piramidat që ai i bekoi dhe mbrojti, i vuri zjarrin Shqipërisë në vitin 1997. Për korrupsionin e tij dhe të familjes së tij u lejuan të vriteshin 26 veta në Gërdec. Për korrupsionin e tij dhe të aleatit të tij, Ilir Meta, u vranë 4 veta më 21 janar. Është e sigurt që korrupsioni i non grata-s ka një listë më të gjatë se sa kaq, por duket se dy ngjarjet, 21 janari i vitit 2011 dhe 15 marsi i vitit 2008 janë dy ngjarjet nga të cilat Sali Berisha nuk do të shpëtojë dot. Unë e kuptoj, e dëshmoj në vetë të parë, duke e parë dhe duke e dëgjuar këtu, në këtë sallë, njësoj siç e kam dëgjuar pas 21 janarit, që Sali Berishës i duhet kaosi, dhuna verbale, degradimi i jetës parlamentare. Këto i duhen edhe aleatit të vjetër të pushtetit për halle të tjera, por që nganjëherë përzihen rëndë si mënyra për ta zhvendosur fokusin, për të intimiduar në mënyrë direkte apo indirekte këdo prokuror apo gjyqtar, sigurisht, për të vrarë shpresën se ky vend mund të bëhet. Ky vend mund të bëhet. Jemi ne ata që duhet t'ia tregojmë vendin njëherë e përgjithmonë këtij soji politikanësh që për shkak të kohës, për shkak të rrethanave riciklohen e riciklohen, duke i ngelur vendit në qafë. Ka ardhur momenti për t'i hequr qafe, duke shfrytëzuar vetëm një mjet, mjetin më të sigurt, më demokratik dhe me efekt përfundimtar: zgjedhjet.

Përballja jonë do të jetë më 14 maj. Atë ditë ne do të konstatojmë, dikush me hidhërim dhe dikush me kënaqësi, se në cilën anë na kanë vendosur veprimet dhe mosveprimet tona. Unë jam e bindur se ne do të jemi në anën e shumicës, pasi, sido që ju të silleni, çfarëdo që ju të bëni dhe sado që ta përshkallëzoni gjuhën edhe sjelljen, ne do të vijojmë të mendojmë në funksion të shumë e shumë interesave që kanë qytetarët. Kemi hyrë në rrugën e integritit dhe atë do ta çojmë deri në fund. Ne premtuam mbrojtje për më të dobët në një realitet të ri dhe në një kontekst krejt të ri shoqëror që ka ardhur krejt papritur, dhe këtë po e bëjmë prej një viti. Po u japim mbrojtje të gjitha kategorive më të dobëta: grave, fëmijëve, pensionistëve, biznesit të vogël dhe të mesëm, punonjësve të thjeshtë, qofshin në publik apo privat, të gjithë mësuesve, të gjithë mjekëve, infermierëve, studentëve dhe ushtarakëve. Në fjalorin tonë politik gjenden këta emra, tek ju nuk i gjej. Me sa duket, makthet për të nesërmen jua kanë errësuar aq shumë pamjen, saqë nuk arrini të dalloni se çfarë dhe kë keni përpara. Kolegë, kushdo që e ka të shëndoshë arsyen, le ta përdorë atë, pa lejuar që orët tona të punës t'i prishin ata që parlamenti më shumë i ka parë se e kanë parë, ata që të qenit të zgjedhur këtu e ngatërrojnë me shumëçka tjetër dhe përgjegjësinë ndaj zgjedhësve e kanë shkëmbyer me devotshmërinë e verbër ndaj liderit. Ne mund të jemi vetvetja, sigurisht, sipas bindjeve dhe qasjeve tona. Të gjithë mund ta bëjmë për qytetarin, pra mund t'i përdorim drejt ligjet, atëherë me siguri, jam e bindur, disave këtu do t'u vijë turp se si e shfrytëzuan kohën e të qenit në parlament dhe sa mosmirënjohës u treguan ndaj atyre qytetarëve që u patën besuar, duke i sjellë këtu.